

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 584 Prot.

Vlorë, më 21/02/2023

**Lënda :** Kërkesë për shpallje publike të tre akteve administrativ

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit

- Sektorit të Monitorimit të Borxhit Doganor

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të tre akteve administrativ – Vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore si vijon :


- Nr.10, me Nr.147/4 Prot., datë 17/02/2023 dhe Nr.11, me Nr.147/5 Prot., datë 17/02/2023, të materializuar për subjektin “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R, me seli në Vlorë (Fshati Mifol, Zona Kadastrale 2689, nr pasurie 135/13-T, Rruga nacionale Vlorë-Fier Km 15).
- Nr.12, me Nr.125/2 Prot., datë 17/02/2023, i materializuar për subjektin “MEDICAL MASEDA” sh.p.k, me NIPT M06608201K, me seli në Vlorë (Lagjja “Bashkimi”, Rruga “Hasan Tasin”, objekti nr.924, kati i parë).

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes publike të akteve të lartcituara.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETAR**

Artaq Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 147/4 .....Prot.

Vlorë, më 17/02/2023

**VENDIM Nr. 10**

Sot, më datë 17/02/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore nr.147/3 Prot., datë 16.01.2023, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "InMec" sh.p.k, me NIPT L77308202R, me seli në Vlorë (Fshati Mifol, Zona Kadastrale 2689, nr pasurie 135/13-T, Rruga nacionale Vlorë-Fier Km 15), si dhe praktikën doganore,

**KONSTATOVA SE:**

Subjekti "InMec" sh.p.k, me NIPT L77308202R, ka përfitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr.AL 6439/1, datë 03.04.2020. Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqytjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk është dorëzuar në degën doganore mbikqyrëse Aneksi nr.8 "Dokumentit i mbylljes së autorizimit", brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230 të Kodit Doganor, edhe pse subjekti është njoftuar nga Dega e Doganës. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar nga Dega e Doganës Vlorë, ke rezultuar se gjendja në magazinën e subjektit është zero. Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.


Për sa më lart, mbështetur në nenet 230, 250/1/a, 251, 256/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv",

**VENDOSA:**

- Subjekti "InMec" sh.p.k, me NIPT L77308202R, të penalizohet në shumën 20,000 (Njëzetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/b të Kodit Doganor.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "InMec" sh.p.k, me NIPT L77308202R, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 125/2 ..... Prot.

Vlorë, më 17/02/2023

**VENDIM Nr. 12**

Sot, më datë 17/02/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore nr.125/1 Prot., datë 19.01.2023, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "MEDICAL MASEDA" sh.p.k, me NIPT M06608201K, me seli në Vlorë (Lagjja "Bashkimi", Rruga "Hasan Tasin", objekti nr.924, kati i parë), si dhe praktikën doganore,

**KONSTATOVA SE:**

Subjekti "MEDICAL MASEDA" sh.p.k, me NIPT M06608201K, operon nën Regjimin e Përpunimit Aktiv me autorizimin Nr.11231/1 Ref., datë 15.07.2020. Ky subjekt e ka mbyllur këtë autorizim doganor me deklaratën doganore IM.4 R 7218, datë 27.05.2022, por ka paraqitur kërkesën me Aneks Nr.8, në datë 11.01.2023 për mbylljen e autorizimit duke shkelur afatin njëmuajor në bazë të Kodit Doganor dhe Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv".

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.


Për sa më lart, mbështetur në nenet 230, 250/1/a, 251, 256/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv",

**VENDOSA:**

- Subjekti "MEDICAL MASEDA" sh.p.k, me NIPT M06608201K, të penalizohet në shumën **20,000** (Njëzetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/b të Kodit Doganor.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "MEDICAL MASEDA" sh.p.k, me NIPT M06608201K, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

**KRYETAR**

Artan Bedina





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 147/5 Prot.

Vlorë, më 17/02/2023

**VENDIM Nr. 11**

Sot, më datë 17/02/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore nr.147/4 Prot., datë 16.01.2023, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "InMec" sh.p.k, me NIPT L77308202R, me seli në Vlorë (Fshati Mifol, Zona Kadastrale 2689, nr pasurie 135/13-T, Rruga nacionale Vlorë-Fier Km 15), si dhe praktikën doganore,

**KONSTATOVA SE:**

Subjekti "InMec" sh.p.k, me NIPT L77308202R, ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr.AL 22903/1, datë 08.04.2020. Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk është dorëzuar në degën doganore mbikqyrëse Aneksi nr.8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230 të Kodit Doganor, edhe pse subjekti është njoftuar nga Dega e Doganës.

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Për sa më lart, mbështetur në nenet 230, 250/1/a, 251, 256/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv",

**VENDOSA:**

- Subjekti "InMec" sh.p.k, me NIPT L77308202R, të penalizohet në shumën 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/b të Kodit Doganor.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "InMec" sh.p.k, me NIPT L77308202R, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

**KRYETAR**  
**Artan Bedinaj**

